

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: MARRJE ME QIRA E DY AUTOMJETEVE

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 60171000-7.

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,133,333 (Tre milion e njëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit të përcaktuara në Shtojcën 8, pika 1 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 8 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 datë 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 19 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara

sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë dhe të paraqesë certifikatë (të vlefshme, dhe në përputhje me objektin e prokurimit), si më poshtë:

SH EN ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente / të barazvlefshme.

Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë, si sistem i lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit.

Standardi ISO 9001:2015 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë” është i nevojshëm pasi garanton Autoritetin Kontraktor se operatori ekonomik disponon procedura të menaxhimit të cilësisë për realizimin e shërbimit objekt kontrate, duke siguruar mirëmbajtjen, sigurinë, funksionalitetin dhe gatishmërinë operative të automjeteve gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se merr përsipër pajisjen e mjetit me siguracionin e nevojshëm, për të gjithë periudhën e qirasë së plotë operacionale.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se do të mbulojë të gjitha detyrimet në lidhje me institucionet përkatëse (taksa rrugore / qarkullimi të vitit përkatës / etj).

Argumentim për kriteret 2.3.3 dhe 2.3.4: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40 pika 3 dhe pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Duke qenë se Operatori ekonomik është pronari i automjeteve që vendos në dispozicion, të gjitha detyrimet që lidhen me automjetin janë pagesë e tij, është thelbësore për garantimin e një shërbimi të sigurt dhe pa kosto shtesë. Këto kushte vendosin përgjegjësi të qarta mbi operatorin ekonomik dhe garantojnë një shërbim të pandërprerë gjatë zbatimit të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë skedën teknike / broshuren / katalogun teknik / fragmente të tyre, me qëllim krahasimin e specifikimeve të mjeteve të ofruara në përputhje me specifikimet teknike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40 pika 6, germa b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter siguron verifikimin e përputhshmërisë së mjeteve të ofruara me specifikimet teknike të përcaktuara në DST, duke garantuar që automjetet e propozuara plotësojnë kërkesat funksionale dhe teknike të nevojshme për realizimin e kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon ambient, ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri duhet të paraqesin:

- Dokumentacionin që vërteton pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje/ kontrata huapërdorje/ çdo dokument tjetër të vlefshëm, me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

Në rast se objekti është me qira apo në përdorim të paraqitet kontrata, e vlefshme, e cila të ketë një afat jo më pak se afati i kontratës dhe të jetë e specifikuar adresa e ambientit.

- Në rast se shërbimi i riparimit apo mirëmbajtjes së mjeteve do të kryhet përmes një servisi me të cilin mund të ketë të lidhur një kontratë bashkëpunimi të vlefshme përgjatë kohës së realizimit të kontratës, ofertuesi duhet të dorëzojë kontratën e bashkëpunimit, ku të jetë e specifikuar adresa e servisit dhe afati i kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Bazuar në natyrën e shërbimit dhe nevojën për garantimin e funksionalitetit dhe sigurisë së automjeteve gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, disponimi i një ambienti për mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve është i nevojshëm për të siguruar realizimin e pandërprerë të shërbimit, mirëmbajtjen periodike si dhe ndërhyrjen në kohë në rast defektesh apo problematikash teknike.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike për mjetet e kërkuara dhe lëvrimit të shërbimit janë përcjellë pranë OBP të hartuara nga grupi i punës i përcaktuar nga titullari i autoritetit kontraktor “Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje” për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Në dokumentacion e hartuar nga grupi i punës, rezulton se:Autoriteti Kontraktor është shprehur si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme lind në zbatim të ligjit 162/2022 “Për prokurimin publik” dhe në zbatim të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” automjete me vit prodhimi jo më të hershëm se viti 2020 dhe me përdorim normal të përshtatshëm për institucione. Kërkesa për kilometrazh të caktuar lind pasi Autoriteti Kontraktues, nuk ka kapacitetet apo mundësitë kohore për të bërë riparime apo zëvendësime të cilat do të kërkonin një kohë të konsiderueshme. Gjithashtu, makinat e përdorura, me kilometrazh shumë të lartë, paraqesin problematika në krahasim me makinat me pak kilometra përdorimi.

Makinat e përdorura për një kohë të gjatë dhe me kilometrazh të lartë kanë amortizim të lartë të viteve të tyre të hershme dhe kosto më të larta në raste defektesh, për të cilat Autoriteti Kontraktues nuk ka kapacitet që ti mbulojë, ndaj këtë do ja kalonte operatorit ekonomik.

Gjithashtu makinat me vit prodhimi të të paktën gjashtë viteve të fundit kanë karakteristika dhe veçori të teknologjisë së fundit, të cilat janë më të sigurt dhe me garanci më të lartë sigurie në raste aksidentesh pra makinat e këtij viti dhe në vijim vijnë me karakteristikat më të fundit të sigurisë dhe janë më të besueshme.

Marrja me qira e makinave me përdorim të pakët çon në garanci më të lartë në rast defektesh, më pak nevojë për riparime dhe kosto më të ulët në mirëmbajtje dhe motorët e tyre janë më efikas.

Të gjitha kërkesat e mësipërme lindin për shkak të nevojës së Autoritetit Kontraktues në përmbushjen e qëllimit të funksionimit të saj, pa cenuar konkurrencën në treg për të marrë pjesë në këtë procedurë

prokurimi të gjithë operatorët ekonomikë, sipas zbatimit të nenit 2 të ligjit 162/2022 “Për prokurimin publik”.

Ky kilometrazh parashikohet si i përshtatshëm për automjetet e përdorura që të mos paraqesin defekte apo problematika në përdorim. Gjithashtu lidhet edhe me faktin që në dispozicion duhet të vendosen automjete jo të konsumuar apo shumë të përdorur.

Për një makinë 6 vjeçare, kilometrazhi normal llogaritet sipas përdorimit mesatar në vit, një makinë zakonisht bën 10,000 – 15,000 km në vit. Për një makinë 6 vjeçare:

60,000 – 90,000 km është shumë mirë / pak e përdorur

90,000 – 120,000 km është përdorim normal

120,000 – 150,000 km është pak më e përdorur por ende normale

150,000+ km konsiderohet shumë e përdorur

Maksimumi i mirë për një makinë 6 vjeçare zakonisht konsiderohet rreth 120,000 km.

Specifikimet më sipër lidhen me anën funksionale dhe me performancën e automjeteve, në zbatim të nenit 36 pika 3/a të ligjit të prokurimit publik. Kriteret janë vendosur pasi ekzistojnë disa lloje automjesh me specifikimet e mësipërme të cilat janë të mundshme për t’ju vënë në dispozicion Autoritetit Kontraktues.

Kriteret e përmasave janë vendosur minimale me qëllim që të mos kufizohet konkurrenca e tregut. Këto kriteret lidhen edhe me komoditetin e pasagjerëve të cilët në ushtrim të kompetencave të tyre të dhëna sipas ligjit do të udhëtojnë jashtë Tirane shpesh herë.

Me specifikimet e mësipërme, synohet të sigurohen dy automjete që jo vetëm plotësojnë nevojat funksionale të autoritetit kontraktor, por kombinojnë efikasitetin financiar, cilësinë e lartë, sigurinë dhe performancën, duke bërë një zgjedhje të qëndrueshme. Automjetet e prodhuara në të paktën pesë vitet e fundit dhe me kilometrazh të ulët sigurojnë një përdorim efikas të burimeve financiare, pasi kanë kosto më të ulëta të mirëmbajtjes dhe riparimeve.

Specifikimet e mësipërme përfshijnë teknologjitë dhe inovacionet më të fundit, duke përmirësuar efikasitetin e përdorimit, përfshirë konsumin e ulët të karburantit dhe performancën e motorit, si dhe ofrojnë nivele të larta sigurie për pasagjerët.

Autoriteti Kontraktues kërkon specifikimet e mësipërme në automjetet të cilat do të përdorë për një periudhë kohore 12 mujore, pasi si një institucion me një agjendë të ngarkuar nuk ka mundësitë dhe kohën për të përballuar problematikën e mundshme që mund të hasen nga automjetet e konsumuara përtej sasisë së arsyeshme të caktuar më sipër. Gjithashtu Autoriteti Kontraktues, kërkon disa lehtësime në përdorim të cilat i mbulojnë specifikimet e mësipërme.

Përdorimi i makinës me kilometrazh të ulët dhe me vit prodhimi 2020 e në vijim siguron një kombinim të performancës dhe teknologjisë së fundit.

Kutia automatike dhe tërheqja 4x4 rrisin përdorueshmërinë dhe sigurinë, duke u përshtatur më mirë për kushtet e ndryshme të rrugës. Kutia automatike dhe tërheqja 2x4 ofrojnë një përvojë më të lehtë të përdoruesit për qytetarët dhe përdoruesit e tjerë. Ndaj të paktën një automjet duhet të ketë tërheqje 4x4 dhe tjetri 2x4.

Aksesorët e përcaktuar (ABS, ESP, Airbag etj.) përmirësojnë sigurinë e makinës. Automjetet duhet të përmbajnë aksesorë shtesë lehtësuese për shoferin dhe pasagjerët, dhe konsumi me karburant i automjeteve të jetë i ulët.

Lidhur me aksesorët shtesë për nuancën e xhamave apo errësimin e xhamave të prapmë argumentojmë se këta janë aksesore standarde që plotësohen nga pjesa më e madhe e prodhuesve të automjeteve. Për Autoritetin Kontraktor e rëndësishme është që mjetet të plotësojnë kërkesat e tij nga ana funksionale dhe nuk është kërkuar përqindja e nuancës apo errësimit të xhamave, parametra që përcaktohen me akte nënligjore. Gjithashtu element i rëndësishëm në përzgjedhjen e automjeteve nga operatori ekonomik është fakti që automjetet të përmbajnë airbag me qëllim kryesor sigurinë e udhëtarëve.

Në përcaktimin e specifikimeve teknike për automjetet objekt prokurimi është vendosur kërkesa që automjetet të jenë në përputhje me standardin Euro 6.

Vendosja e këtij kriteri është bërë në funksion të garantimit të përdorimit të automjeteve që plotësojnë standardet më të fundit europiane për emetimet e gazrave ndotës dhe mbrojtjen e mjedisit. Automjetet me standard Euro 6 sigurojnë nivel më të ulët të emetimeve të dëmshme në atmosferë, duke kontribuar në reduktimin e ndotjes së ajrit dhe në përmirësimin e performancës mjedisore të flotës së automjeteve.

Ky kriter nuk konsiderohet kufizues për konkurrencën, pasi standardi Euro 6 është aktualisht një standard i përhapur gjerësisht në tregun e automjeteve dhe plotësohet nga një numër i madh prodhuesish dhe modelesh automjetesh.

Përcaktimi i këtij standardi është në përputhje me parimet e Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit specifikimet teknike duhet të jenë të lidhura me objektin e kontratës dhe të mos krijojnë pengesa të pajustificuara për konkurrencën, duke garantuar njëkohësisht cilësi dhe standarde të përshtatshme për mallrat që prokurohen.

Në këtë kuadër, kërkesa për standardin Euro 6 konsiderohet kriter teknik proporcional dhe i justifikuar për realizimin e qëllimit të prokurimit.

Mallrat ekuivalente: *Specifikimet teknike të përmendura, janë sqaruar me qëllim që ti krijohet operatorit ekonomik ideja sesi nevojiten automjetet. Specifikimet janë hartuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, të cilat përmbushin kërkesat dhe nevojat e Autoritetit Kontraktues. Në zbatim të nenit 36 të ligjit 162/2020 “Për prokurimet publike” i ndryshuar, pranohen mallra sipas specifikimeve më sipër “ose ekuivalente”.*

Dorëzimi i automjeteve, do të kryhet brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës me operatorin ekonomik.